
	<p align="center"><b>Republika e Kosovës</b>  <b>Republika Kosova –</b>  <b>Republic of Kosovo</b></p> <p align="center"><b>Komuna e Prishtinës</b>  Opština Priština –Municipality  of Prishtina</p>	<p align="center">PRISHTINA</p> 
---	---	---

<b>Datë/a:</b>	30.07.2021
<b>Për/ Za/ To:</b>	Dezinfektimi AD
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 24.07.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik Dezinfektimi AD, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Deratizimi i podrumëve dhe garazheve publike si dhe rrjetit të kanalizimit në Komunën e Prishtinës”** me Nr. të Prok: **616 21 16 211** nxjerr:

## V E N D I M

- I. **Refuzohet** kërkesa e parashtruar nga **Operator Ekonomik** Dezinfektimi AD, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Deratizimi i podrumëve dhe garazheve publike si dhe rrjetit të kanalizimit në Komunën e Prishtinës”** me Nr. të Prok: **616 21 16 211**, kundër Njoftimit për Kontratë të AK –së, të datës 15.04.2021 të publikuar në web-faqe të KRPP-së. të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
- II. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit me titull: **“Deratizimi i podrumëve dhe garazheve publike si dhe rrjetit të kanalizimit në Komunën e Prishtinës”** me Nr. të Prok: **616 21 16 211**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## Arsyetim

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 15.04.2021 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Deratizimi i podrumëve dhe garazheve publike si dhe rrjetit të kanalizimit në Komunën e Prishtinës”** me Nr. të Prok: **616 21 16 211**

Me datë 23.07.2021, **Operator Ekonomik: VLERA SH.P.K.** ka bërë kërkesë për rishqyrtim me c’rast ka paraqitur:

### **Pretendimet ankimore:**

Ne kërkesen për Kapacitetin teknik dhe profesional është kërkuar që të largohet kriteri që lideri duhet të ketë 60% e realizimit të kontratave.

### **Baza juridike për refuzim të kërkesës**

Autoriteti Kontraktues ka dhënë sqarimet në vendimet e mëhershme lidhur me pretendimet ankimore dhe duke pasur parasysh se qysh në fillim janë paraqitur pengesa të vazhdueshme për vazhdimin e këtij aktiviteti lidhur me specifikimin teknik dhe kriteret e dosjes atëherë autoriteti kontraktues vendos që të bëjë anulimin e këtij aktiviteti.

### **Këshilla juridike:**

*Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.*